



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026
ME ZGJEDHJE - SESIONI I

SKEMË VLERËSIMI

Ekonomi

Varianti A

23 qershor 2026

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

<i>Pyetja</i>	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
<i>Alternativa e saktë</i>	A	B	D	A	D	D	C	B	D	B
<i>Pyetja</i>	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
<i>Alternativa e saktë</i>	B	D	D	B	D	A	D	C	C	B

Vlerësimi është 1 pikë për çdo përgjigje të saktë

Përgjigjet e sakta për pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikë, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Pyetja 21 3 pikë

Model përgjigjeje

- Para elektronike.
- Paraja shërben si mjet pagese ose mjet shkëmbimi.
- Është më e lehtë; më e sigurt; më praktike se përdorimi i parasë kesh etj.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse përcakton formën e parasë, funksionin dhe avantazhin e përdorimit të kartës bankare;

2 pikë nëse përcakton formën e parasë dhe funksionin; nëse përcakton formën e parasë dhe avantazhin e përdorimit të kartës bankare; nëse përcakton funksionin e parasë dhe avantazhin e përdorimit të kartës bankare;

1 pikë nëse përcakton formën e parasë; nëse përcakton funksionin e parasë; nëse përcakton avantazhin e përdorimit të kartës bankare;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 **3 pikë**
Model përgjigjeje

a) Probleme mikroekonomike:

- 1) Një fabrikë po shqyrton mundësinë për të rritur çmimet.
- 2) Disa fabrika po përballen me rritjen e kostove të prodhimit.
- 3) Një fabrikë po shqyrton mundësinë për të ulur prodhimin.
- 4) Një fabrikë po shqyrton mundësinë për të shmangur humbjet.

b) Pse konsiderohen probleme mikroekonomike:

- 1) Janë probleme mikroekonomike sepse lidhen me sjelljen dhe vendimmarrjen firmave në treg.

Ose

Mikroekonomia studion si firmat dhe konsumatorët marrin vendime për çmimet, prodhimin dhe përdorimin e burimeve.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse identifikon dy probleme mikroekonomike dhe shpjegon pse ato konsiderohen të tilla.

2 pikë nëse identifikon dy probleme mikroekonomike; nëse identifikon një problem mikroekonomik dhe shpjegon pse konsiderohet i tillë.

1 pikë nëse identifikon një problem mikroekonomik; nëse shpjegon pse konsiderohet problem mikroekonomik.

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **3 pikë**
Model përgjigjeje

a) Ky çmim quhet çmim tavan.

b) Në treg do të kemi tepricë kërkese ose mungesë oferte.

Kjo tepricë kërkese do të shoqërohet me:

- 1) Radhë të gjata
- 2) Humbje kohe
- 3) Ineficiencë ekonomike.
- 4) Dukurinë e mitëmarrjes ose korrupsion.
- 5) Lulëzim i tregut informal (tregut të zi).

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse identifikon çmimin dhe përcakton dy pasoja;

2 pikë nëse identifikon çmimin dhe përcakton një pasojë; nëse përcakton dy pasoja;

1 pikë nëse identifikon çmimin; nëse përcakton një pasojë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **2 pikë**
Model përgjigjeje

Ndikimi:

- Nëse Shqipëria rrit eksportet dhe ul importet vlera e lekut do të rritet ndaj euros.
- Leku shtrenjtohet ndërsa euro bëhet më e lirë (lirësohet).

Arsye:

- Rritja e eksporteve sjell hyrje më të madhe të euros (valutës së huaj) duke rritur ofertën e saj dhe ulja e importeve do të thotë se kërkesa për euro (valutë) ulet, çmimi i euros (valutës) bie. Si rrjedhojë, leku forcohet pasi duhen më pak lekë për të blerë njësi të euros (valutës së huaj).

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse përcakton ndikimin dhe jep një arsye;

1 pikë nëse përcakton ndikimin; nëse jep një arsye;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 4 pikë

Model përgjigjeje

a) TPP për 6 punëtorë është 120 njësi sepse punëtori shtesë ka prodhuar 20 njësi shtesë.

Ose

$$MPP = \frac{\Delta TPP}{\Delta L} \quad MPP_6 = \frac{TPP_6 - TPP_5}{L_6 - L_5} \quad 20 = \frac{TPP_6 - 100}{6 - 5} \quad TPP_6 = 100 + 20 = 120$$

TPP për nivelin 6 është 120

b) $APP = \frac{TPP}{L} = \frac{120}{6} = 20$

c) $ATC = \frac{TC}{TPP} \quad TFC = 500\,000 \quad Paga = 40\,000 \quad TVC = W \times L = 40\,000 \times 6 = 240\,000$

$$TC = TFC + TVC = 500\,000 + 240\,000 = 740\,000 \quad ATC = \frac{740\,000}{120} = 6\,166.67$$

$\approx 6\,166$

d) $TR = P \times TPP = 4000 \times 120 = 480\,000$

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse llogarit TPP, APP, ATC dhe TR;

3 pikë nëse llogarit TPP, APP dhe ATC; nëse llogarit TPP, APP dhe TR; nëse llogarit APP, ATC dhe TR; nëse llogarit TPP, ATC dhe TR;

2 pikë nëse llogarit TPP dhe APP; nëse llogarit ATC dhe TR; nëse llogarit TPP dhe ATC; nëse llogarit TPP dhe TR;

1 pikë nëse llogarit TPP; nëse llogarit APP; nëse llogarit ATC; nëse llogarit TR;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26 3 pikë

Model përgjigjeje

1) Për të dyja format e organizimit të biznesit fondet kapitale janë të kufizuara.

2) Aftësia për të marrë hua është e kufizuar si për firmën individuale edhe për atë me ortakë.

3) Përgjegjësia të të dy format e organizimit të biznesit është e pakufizuar.

4) Jetëgjatësia e biznesit është e kufizuar. Jetëgjatësia e biznesit varet nga jetëgjatësia e pronarëve.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shpjegon tri të meta;

2 pikë nëse shpjegon dy të meta;

1 pikë nëse shpjegon një të metë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 27 **3 pikë**

Model përgjigjeje

Produkt i duhur:

- Aplikacion për guidat turistike.
- Aplikacion për menaxhimin e shërbimeve turistike.
- Platformë digjitale për organizimin e shërbimeve turistike.

Përparësi konkurruese:

- Lehtëson organizimin e guidave dhe shërbimeve turistike.
- Rrit efikasitetin në menaxhimin e fluksit të turistëve me kosto të ulët.

Sipërmarrës i informuar:

- Analizon të dhënat e tregut.
- Identifikimi i rritjes së fluksit të turistëve.
- Vendimmarrje e bazuar në nevojat e tregut turistik.
- Analiza e kërkesës së lartë për shërbime turistike.
- Analizon problemin e mungesës së guidave dhe merr vendim bazuar në informacion.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse identifikon tre elementë në situatën e dhënë;

2 pikë nëse identifikon dy elementë në situatën e dhënë;

1 pikë nëse identifikon një element në situatën e dhënë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 **4 pikë**

Model përgjigjeje

a) Instrumentet monetarë:

1) Banka Qendrore blen letra me vlerë shtetërore.

Blen bono thesari.

Blen obligacione shtetërore.

Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes.

2) Ul normën e rezervës së detyrueshme.

3) Ul normën e skontos (rifinancimi).

Ul normën e interesit që Banka Qendrore u jep hua bankave të nivelit të dytë.

b) Efektet që do të sjelli në ekonomi:

1) Rritet GDP.

- 2) Ulet papunësia.
 - 3) Rritet inflacioni.
 - 4) Rritet prodhimi.
 - 5) Rritet punëzënia.
 - 6) Rritet oferta monetare.
 - 7) Ulet norma e interesit.
 - 8) Rriten investimet e firmave.
 - 9) Rriten shpenzimet e konsumatorëve.
- Etj.

Nxënësi fiton:

- 4 pikë** nëse analizon dy instrumente monetarë të përdorur dhe dy efekte në ekonomi;
- 3 pikë** nëse analizon dy instrumente monetarë të përdorur dhe një efekt në ekonomi; nëse analizon një instrument monetar të përdorur dhe dy efekte në ekonomi;
- 2 pikë** nëse analizon dy instrumente monetarë të përdorur; nëse analizon një instrument monetar të përdorur dhe një efekt në ekonomi;
- 1 pikë** nëse analizon një instrument monetar të përdorur; nëse analizon një efekt në ekonomi;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29 3 pikë
Model përgjigjeje

- a) Sasia optimale është pika kur $MR = MC$
 $Q = 50$ njësi
- b) $TC = ATC \times Q$ Sepse $ATC = \frac{TC}{Q}$ $TC = ATC \times Q = 60 \times 50 = 3\,000$ lekë
- Kosto totale = 3 000 lekë*
- c) $Fitimi = TR - TC$ për $Q = 50$ $TR = P \times Q = 80 \times 50 = 4\,000$ lekë
Fitimi = 4 000 - 3 000 = 1 000 lekë. Në këtë rast firma po vepron me fitim

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse analizon sasinë optimale dhe llogarit TC dhe fitimin;
- 2 pikë** nëse analizon sasinë optimale dhe llogarit TC; nëse analizon sasinë optimale dhe llogarit fitimin; nëse llogarit TC dhe fitimin;
- 1 pikë** nëse analizon sasinë optimale; nëse llogarit TC; nëse llogarit fitimin;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30 3 pikë
Model përgjigjeje

- a) Përqindja e ndryshimit në çmim është e barabartë me zero, sepse pavarësisht se sa rritet përqindja e ndryshimit në sasinë e ofruar, çmimi mbetet i pa ndryshuar.

Ose

$$\% \Delta P = \frac{P_2 - P_1}{P_1} \times 100 = \frac{100 - 100}{100} \times 100 = 0\%$$

Ose

$$\% \Delta P = \frac{P_2 - P_1}{\frac{(P_2 + P_1)}{2}} \times 100 = 0\% \quad \% \Delta P = \frac{100 - 100}{\frac{100 + 100}{2}} \times 100 = 0\%$$

b) Elasticiteti i ofertës është i barabartë me ∞ (infiniti).


Ose

Kur përqindja e ndryshimit në çmim është e barabartë me 0 dhe përqindja e ndryshimit në sasinë e ofruar rritet vazhdimisht, $E_s = \infty$.

Ose

$$E_s = \infty$$

c) Paraqitja grafike:



Nxënësi fiton:

3 pikë nëse analizon përqindjen e ndryshimit në çmim, elasticitetin e ofertës dhe bën paraqitjen grafike;

2 pikë nëse analizon përqindjen e ndryshimit në çmim dhe elasticitetin e ofertës; nëse analizon përqindjen e ndryshimit në çmim dhe bën paraqitjen grafike; nëse analizon elasticitetin e ofertës dhe bën paraqitjen grafike;

1 pikë nëse analizon përqindjen e ndryshimit në çmim; nëse analizon elasticitetin e ofertës; nëse bën paraqitjen grafike;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 **3 pikë**

Model përgjigjeje

a) Përqindja e taksës që paguan familja e Endit $\frac{1\,200}{60\,000} \times 100\% = 2\%$

b) Përqindja e taksës që paguan familja e Albës $\frac{1\,200}{120\,000} \times 100\% = 1\%$

c) Në këtë rast kemi të bëjmë me taksë regresive, pasi familja e Endit që ka më pak të ardhura paguan një përqindje më të lartë takse se familja e Albës që ka më shumë të ardhura dhe paguan një përqindje më të ulët takse.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse llogarit përqindjen e taksës që paguan Endi dhe Alba dhe argumenton llojin e taksës;

2 pikë nëse llogarit përqindjen e taksës që paguan Endi dhe Alba; nëse llogarit përqindjen e taksës që paguan Endi dhe argumenton llojin e taksës; nëse llogarit përqindjen e taksës që paguan Alba dhe argumenton llojin e taksës;

1 pikë nëse llogarit përqindjen e taksës që paguan Endi; nëse llogarit përqindjen e taksës që paguan Alba;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **3 pikë**
Model përgjigjeje

- a) $Forca\ punëtore = të\ punësuar + të\ papunë = 60\ milionë + (5\ milion + 20\ milionë + 15\ milionë) = 60\ milionë + 40\ milionë = 100\ milionë$
- b) $Norma\ e\ papunësisë = \frac{të\ papunë}{forca\ punëtore} \times 100\% = \frac{40\ milionë}{100\ milionë} \times 100\% = 40\%$
- c) $Norma\ natyrore\ e\ papunësisë = \frac{(papunësi\ friksionale + papunësi\ strukturore)}{forca\ punëtore} \times 100\%$
 $= \frac{(5\ milion + 20\ milionë)}{100\ milionë} \times 100\% = \frac{25\ milionë}{100\ milionë} \times 100\% = 25\%$

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse llogarit forcën punëtore, normën e papunësisë dhe normën natyrore të papunësisë;
2 pikë nëse llogarit forcën punëtore dhe normën e papunësisë; nëse llogarit forcën punëtore dhe normën natyrore të papunësisë; nëse llogarit normën e papunësisë dhe normën natyrore të papunësisë;
1 pikë nëse llogarit forcën punëtore; nëse llogarit normën e papunësisë; nëse llogarit normën natyrore të papunësisë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33 **3 pikë**
Model përgjigjeje

- 1) Lexon duke kuptuar materialet mësimore, udhëzimet dhe dokumentacionin shkollor.
 - 2) Përcjell idetë me shkrim gjatë hartimit të planeve mësimore, raporteve dhe dokumentacionit të nevojshëm.
 - 3) Flet në mënyrë që të tjerët të kuptojnë gjatë mësimdhënies dhe komunikimit me nxënësit, kolegët dhe prindërit.
 - 4) Dëgjon në mënyrë aktive nxënësit dhe kolegët për të kuptuar nevojat dhe shqetësimet e tyre.
 - 5) Vrojton me kujdes ecurinë dhe sjelljen e nxënësve për të identifikuar nevojat e tyre.
 - 6) Planifikon mësimdhënien, aktivitetet shkollore dhe detyrat profesionale.
 - 7) Zgjidh probleme dhe merr vendime në situata që lidhen me procesin mësimor dhe organizimin e punës.
 - 8) Bashkëpunon me të tjerët për realizimin e aktiviteteve dhe arrijen e objektivave të përbashkëta.
 - 9) Përkrah dhe ndihmon nxënësit dhe kolegët kur kanë nevojë për mbështetje.
 - 10) Zgjidh dhe negocion konfliktet që mund të lindin në mjedisin shkollor.
 - 11) Udhëzon të tjerët duke orientuar dhe mbështetur nxënësit në procesin e të nxënës.
 - 12) Merr përgjegjësi për të mësuar dhe për zhvillimin e vazhdueshëm profesional.
 - 13) Reflekton dhe vlerëson punën e saj për të përmirësuar rezultatet e mësimdhënies.
 - 14) Mëson nëpërmjet kërkimit për të përditësuar njohuritë dhe metodat e mësimdhënies.
 - 15) Përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie, komunikim dhe menaxhimin e dokumentacionit shkollor.
- Etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse përshkruan tri aftësi për situatën e dhënë;
2 pikë nëse përshkruan dy aftësi për situatën e dhënë;
1 pikë nëse përshkruan një aftësi për situatën e dhënë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

